

Rregullore për Procedurën e Ankesave/apelleve të studentëve në Akademinë Evolucion

Hyrje

Me këtë rregullore përcaktohen procedurat e paraqitjes dhe trajtimit të Ankesave të studentëve të Akademisë Evolucion në rast të ndonjë pakënaqësie me vlerësim në provim apo punë individuale/projekt të studentit, shkeljes dhe parregullësi në procedurat administrative për studentë, shkeljes së të drejtave tjera të parapara me Statut apo paraqitjes së ndonjë pengese gjatë studimeve në Akademinë Evolucion.

- Një ankesë apo apel është një kërkesë nga një student që një vendim i një stafi akademik apo administrativ i marrur për të, duhet të rishikohet sepse mendohet se atij i është bërë një padrejtësi.
- Procedurat në vijim përcaktojnë bazat për të bërë një ankesë/apel dhe përshkruajnë se si ato do të trajtohen dhe dëgjohen.
- Këto procedura zbatohen për të gjithë studentët aktiv të Akademisë Evolucion në lidhje me vendimet që lidhen me përparimin e studentëve dhe/ose çmimet akademike dhe procedurat administrative.
- Akademia Evolucion kërkon të zgjidhë të gjitha ankesat/apelime të përmes proceseve të brendshme të saj, mbështetur nga rregulloret e secilit program studimi.
- Nëse një student fillon procedura ligjore ndaj Akademisë Evolucion, procedura e ankesës do të pezullohet derisa këto procedura të përfundojnë.

Parimet bazë

- Kushdo që merr vendime duhet të jetë i paanshëm, që do të thotë se nuk duhet të ketë konflikt interes personal në rezultatit e çështjes dhe nuk duhet të ketë asnjë paragjykim nga ana e anëtarëve të stafit që shqyrton një ankesë në asnjë fazë të këtyre procedurave.

- Personat që marrin pjesë në vendim-marrje duhet të jenë në gjendje ta shqyrtojë çështjen plotësisht mbështetur në rregulloret e institucionit dhe *në dritën e të gjitha provave në dispozicion*.
- Çdo student që paraqet një ankesë normalisht do të lejohet të vazhdojë të ndjekë programin për të cilin është regjistruar, në pritje të rezultatit të ankesës.

Procedura

- Studenti para se të paraqesë Ankesë me shkrim për pakënaqësitë ndaj vlerësimit në provim, ai duhet ti drejtohet mësimdhënësit të lëndës që të shprehë mospajtimin e tij dhe të kërkojë sqarime me shkrim lidhur me vlerësimin e bërë nga ai. Kjo procedurë duhet të bëhet brenda afatit kohor të paraparë në rregulloren për vlerësim të studentëve.
- Nëse edhe pas bisedës me mësimdhënësin, studenti konsideron se i është bërë padrejtësi apo nuk është vlerësuar sipas meritës që ai mendon, ai ka të drejtë që të paraqesë Ankesë me shkrim Komisionit për ankesa të studentëve, në të cilin mësimdhënësi nuk është anëtar.
- Ankesat e studentëve mund të bëhen në formë individuale, kur vetëm një student shpreh mospajtimin ose pakënaqësinë e tij, ose mund të jetë si grup, nëse një grup studentësh konsideron se ka bazë për të shprehur bashkarisht pakënaqësinë me ndonjë veprim apo procedurë.
- Në të dyja rastet, Ankesa duhet të paraqitet me shkrim me Formularin e paraparë për këtë qëllim dhe duhet të nënshkruhet nga studentit/studentët.
- Nëse ankesa është grupore, ajo duhet të nënshkruhet nga secili student i grupit që ka paraqitur ankesën, për të dëshmuar se ai vullnetarisht e mbështet atë dhe qëndron pranë saj.
- Ankesa duhet të përmbajë të dhënat për studentin që bën ankesë, duke përfshirë edhe numrin ID të studentit. Ajo duhet të jetë e formuluar qartë, e arsyetuar dhe nuk mund të përmbajë çështje jashtë funksionit të institucionit arsimor të cilit i drejtohet.



- Formulari për Ankesa mirret te zyrtarja për çështje studentore, plotësohet nga studenti/studentët dhe protokolohehet në arkiv, pastaj dorëzohet i plotësuar te zyrtarja e njejtë.
- Ankesës duhet ti bashkangjiten edhe prova faktike sipas mendimit të ankimesit/ankimesve që ajo të jetë e bazuar dhe të trajtohet nga Komisioni.
- Nëse nuk paraqiten prova faktike apo të motivuara, ankesa/apeli do të konsiderohet e pa bazuar.
- Kjo Ankesë brenda javës përcjelllet te Komisioni për Ankesa të studentëve, i cili në afatin kohor prej 10 ditësh të punës do ti jep studentit një përgjigje me shkrim ndaj Ankesës së tij. Përgjigja e Komisionit të Ankesave duhet të protokolohehet dhe të ruhet në arkiv si dëshmi.

Komisioni i Ankesave

- Komisioni i Ankesave duhet të përbëhet prej tre anëtarëve, prej të cilëve dy nga stafi akademik dhe një përfaqësues nga stafi joakademik i AE.
- Anëtarët e Komisionit të ankesave duhet të jenë me kredibilitet, të paanshëm dhe pa konflikt interesi.
- Komisioni i ankesave e emëron njërin prej anëtarëve të saj si kryesues për ti udhëhequr takimet e komisionit dhe ato me palët tjera të përfshira në rastet e paraqitura.
- Komisioni i Ankesave nuk e luan rolin e gjykatësit por ka për detyrë që të propozojë zgjidhje për pakënaqësitë e paraqitura.
- Gjatë shqyrtimit të ankesave, me qëllim të ardhjes te një përfundim i drejtë dhe i arsyeshëm Komisioni i ankesave, ka të drejtë që ta ftojë në takim studentin që ka paraqitur ankesën, mësimdhënësin për të cilin është paraqitur ankesa ose zyrtarin e administratës, nëse ankesa ka të bëjë me procedura administrative.

- Komisioni i ankesave ka të drejtë që në takimin për shqyrtimin e ankesës të ballafaqojë studentin me mësimdhënësin ose personin administrativ për të cilët është bërë ankesa, me qëllim të marrjes së informatave nga të dyja palët njëkohësisht ose arritjes së një pajtimi rreth çështjes së apeluar.
- Komisioni ka të drejtë që, varësisht prej natyrës së ankesës, të thërras në takimin për shqyrtim të ankesës dhe provave të paraqitura edhe drejtorin e akademisë, shefin e departamentit, drejtorin e administratës dhe përfaqësuesin e studentëve.
- Pas këtyre takimeve komisioni duhet të marrë mendimin e studentin që ka paraqitur ankesën nëse ai mbetet pranë saj ose nëse vendos që ta tërhiqet atë.
- Procesverbali nga takimi i Komisionit duhet të mbahet nga një zyrtar administrativ që nuk është anëtar i këtij komisioni.
- Në rastet kur ankesa e studentit paraqet ndonjë shkelje të dinjitetit ose moralit të studentit, e që deshmohet me fakte mbështetëse ose deshmuarë të rastit dhe që konsiderohet nga Komisioni i ankesave si cenim i Kodit të Etikës së Akademisë Evolucion, komisioni duhet ta adresojë çështjen te Komisioni i etikës, i cili e vlerëson atë dhe propozon masat disiplinore adekuate.

Vendimet e Komisionit të Ankesave

Pas shqyrtimit të Ankesës dhe materialeve përcjellëse, Komisioni do të konstatojë njërën nga këto:

- a) Që studentin nuk ka vërtetuar asnjë bazë për rishqyrtim dhe për këtë arsye vendimi fillestar i mësimdhënësit që e ka vlerësuar provimin apo i Komisionit vlerësues të punimit individual mbetet në fuqi.
 - b) Që studentin ka paraqitur fakte të mjaftueshme për rishqyrtim të vlerësimit dhe që ankesa/apeli të jetë mbështetur.
- Në këtë rast, Komisioni i ankesave do të propozojë që mësimdhënësi i njëjtë ta bëjë rivlerësimin e provimit/punimit të studentit, apo nënshtrimin e sërishëm në provim.

- Nëse edhe pas kësaj procedure studenti shprehë pakënaqësi me vlerësimin, Komisioni i ankesave do të propozojë, me miratimin e udhëheqësit të departamentit përkatës, formimin e një Komisioni nga 3 mësime të fushës së afërt me lëndën për të cilën është apeluar vlerësimi, në të cilin nuk është pjesë mësime të cilët ka vlerësuar studentin.
- Vlerësimi nga ky komision mbetet përfundimtar.
- Në rast të Ankesës për shkelje apo padrejtësi gjatë procedurës administrative, që studenti ka paraqitur fakte të mjaftueshme për rishqyrtim të procedurës së zbatuar administrative ankesa/apeli e tij do të mbështetet.
- Në këtë rast komisioni i ankesave do të propozojë korigjimin e procedurës dhe zbatimin e saj sipas rregulloreve në fuqi për procedurën e apeluar.

Kur studenti nuk mund të bëjë Ankesë

Studenti nuk ka të drejtë të bëjë ankesë në këto raste:

- Nëse ai nuk është në dijeni të rregulloreve dhe procedurave të publikuara të vlerësimit për një modul, lëndë ose kurs.
- Nëse ai nuk është në dijeni apo mjaftueshëm i informuar për procedurën administrative për të cilën ankohet.
- Nëse nuk pajtohet me gjykimin akademik ose profesional të mësime të cilët ose komisionit që vlerëson rezultatin e një pune individuale, ose në arritjen e ndonjë vendimi vlerësimi bazuar në nota, rangim, përparim ose çmim.

Mbrojtja e të dhënave

- Informacioni i zbuluar nga studenti në ankesë duhet të trajtohet me konfidencialitet dhe të ruhet në mënyrë të sigurt në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave.
- Informacioni duhet të mbahet për një kohëzgjatje të caktuar, përpara se të shkatërrohet në përputhje me rregulloret dhe Dokumentet e Akademisë Evolucion.

- Në rastet kur informacioni i dhënë në ankesë është me rëndësi edhe për departamentet tjera ai informacion mund të ndahet brenda departamenteve të Akademisë Evolucion me qëllim të marrjes së hapave adekuat.
(Psh. nëse ka shqetësime të studentët në lidhje me gjendjen shëndetësore ose aftësinë e një mësimitdhënësi për të ushtruar profesionin, kjo mund të prekë më shumë departamente/programe brenda institucionit).

Dispozita përfundimtare

Kjo Rregullorë hyn në fuqi më datë 20.10.2025.

Drejtori ekzekutiv i AE

Enkelejda Shatri

